



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1344/3 Prot.

Durrës, më 28.05.2026

V E N D I M

Nr. 50, Datë 28.05.2026

PËR

**"RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË "FINANCE ACCOUNTING", PRANË FAKULTETIT TË
BIZNESIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës DIPLOMË Ë
PËRBASHKËT ME INSTITUTIN POLITEKNIK TË BRAGANÇËS"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; referuar shkresës së Fakultetit të Biznesit me nr. 1224 prot., datë 14.05.2026, si dhe referuar relacionit nr. 1224/2 prot., datë 26.05.2026 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, vendimit të Senatit Akademik nr.75, datë 26.05.2026, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e riorganizimit në masën mbi 20% të programit të studimit të ciklit të parë, nga Bachelor në "Finance Accounting" në Bachelor në "Accounting", pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit, të Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, diplomë e përbashkët me Institutin Politeknik të Bragançës.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 25.000 lekë
3. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën Angleze.
4. Kodi i programit të studimit: 63BA0411A.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

